Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Zyra e Drejtorit/ Kancelarija Direktora /Office of the Director

Numër: 02-283
Datë: 01.06.2018

Bazuar në nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20 pika 3 me nën-pikën 3.2, nenin 26, 50 pikat 1,2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe nenin 18 pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare, si dhe nenin 23, pika 1 të Udhëzimit të Administrativ nr. 35/2014 për kriteret dhe procedurat për validim dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Vendoset që të realizohet procesi i monitorimit pas akreditimit nga AKK, bazuar në planin e punës së AKK për vitin 2018.
2. Lejohet angazhimi i ekspertëve të jashtëm sipas nevojës për kualifikime përkatëse.
3. Ekspertët do të lidhin marrëveshje për shërbime të veçanta për ditët e angazhimit.
4. Angazhimi i ekspertëve varet nga kualifikimet që do të monitorohen në institucionin përkatës sipas Udhëzimit Administrativ 35/2014.
5. Për një ditë angazhimi ekspertët lokal do të paguhen 100 euro, ndërsa ekspertët rajonal 200 euro, siç e përcakton UA.
6. Përgjegjësitë dhe detyrat e ekspertëve të monitorimit janë të saktësuara me Udhëzuesin e Monitorimit (UM) të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP).
7. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Vendimi merret bazuar nw Ligjin për Kualifikime Kombëtare i cili e obligon Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) që të hartoj, rregulloj dhe menaxhoj Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), si dhe me qëllim të përmbushjes së funksioneve të tjera që dalin nga ky ligj.

Vendimi i dërgohet:

1. Divizionit për buxhet dhe financa;
2. Arkivit të AKK.

Lah Nitaj
Drejtor i AKK